



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.357/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “A...” Sh.p.k, me seli në fshatin ... Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson me autorizim avokat Liman Musa nga Ferizaj rr. “Reçakut”pa nr, ndaj debitorit “E...”, me seli në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, të cilin e përfaqëson pronari M.G., me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan CPK.nr.44/21 të datës 22.09.2021, me datën 21.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e pa afatshme ankesa debitorit “E...”, me seli në fshatin ..., Komuna e Gjilanit e ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm CPK.nr.44/21 të datës 22.09.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.44/21 të datës 22.09.2021, e ka refuzuar prapësimin e debitorit E...”, me seli në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, e paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.194/21 të datës 02.04.2021 të Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, në territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, duke e lënë në fuqi Urdhrin përmbartimor të përmbartuesit privat, ndërsa ka obliguar debitorin të deponoj shumën prej 500 euro ne emër të garancisë si dhe të paguaj taksen prej 30 euro për ushtrim të prapësimit.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë debitori përmes përfaqësuesit të tij M.G., për shkak të shkeljeve substanciale të LPP, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anuloj ndërsa kreditori ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa është e pasafatshme

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar afatshmerinë e ankesës së ushtruar nga ana e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të ankimuar të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Gjilan -Departamenti i Përgjithshëm CPK.nr.44/2021, të datës 22.09.2021, ka konstatuar se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit kohor ligjor të dhënë në këshillën juridike të aktvendimit të ankimuar prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit në dorëzim të të njëjtit aktvendim nga debitorët.

Tek një përfundim i tillë kjo gjykatë vjen për faktin se me shikim në fletë kthesën e cila gjindet si dëshmi në shkresat e lëndës konstatohet se debitori aktvendimin e ankimuar e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 04.10.2021 (ditë e hëne), ndërsa ankesën kundër të njëjtit aktvendim e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjilan me datë 18.11.2021 (ditë e ejte), gjë që vërtetohet nga vula e pranimit të kësaj gjykate e cila është vendosur në ankesën e dorëzuar tek e njëjta gjykatë.

Afati kohor ligjor për ushtrim të ankesës ka qenë afati prej 7 ditësh siç është dhënë edhe në këshillën juridike, i cili ligjërisht ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme prej kur debitori e ka pranuar aktvendimin e ankimuar, që në rastin konkret i bie të ketë filluar nga data 05.10.2021 (ditë e marte) e ku me shikim në kalendarin mujor Tetor për vitin 2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e ankesës – duke marrë afatin e dhënë në këshillën juridike ka qenë data 11.10.2021(ditë e hëne), datë kjo kur edhe ka skaduar afati kohor ligjor prej 7 ditësh i dhënë në këshillën juridike. Nga kjo rezulton se debitori ka paraqitur ankesë 45 ditë më vonë, pra jashtë afatit kohor.

Afatet kohore të përcaktuara me ligj, janë të pandryshueshme dhe nuk mund të zgjaten apo shkurtohen as me vendim të gjykatës e as me marrëveshjen e palëve. Afati ligjor ka karakter prekluziv, sepse veprimi procedural i lidhur për afatin ligjor nuk mund të kryhet pas skadimit të tij.

Dhoma e Shkallës së Dytë, në kuptim të rrethanave të paraqitura më lart gjen se ankesa është e palejueshme pasi që me dispozitën e nenit 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”,* si dhe në bazë të nenit 186 paragrafi 2 të LPK-së është e paraparë se *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”,* ndërsa me dispozitën e nenit 196 përcaktohet se : *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme e hedhë poshtë gjykata e*

shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së”.

Kështu në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë me të cilën do të konfirmohej se ankesa është dorëzuar në ndonjë datë tjetër, prandaj nga arsyet e mësipërme, Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti se ankesa e debitorit është e pa afatshme, të cilën kjo gjykatë e hedhë poshtë në pajtim me nenin 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, si dhe nenin 186 paragrafi 2, 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-DHOMA E SHKALLËS SE DYTË

K.DH.SH.II nr.357/22, me datë 21.11.2022

**Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri**